

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021*

**24.03.2021
Ora 13:38**

RENDI I DITËS


Projektakti "Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 06, datë 20.03.2021 nga koalicioni Aleanca-Al, "Kundërshtimin e vendimit nr. 165, datë 18.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumemërore të koalicionit Aleanca-Al, për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë datë 25 prill 2021".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** Koalicioni Aleanca-Al

Z. E. Çefa: Atëherë mirëdita të gjithëve! Deklarojmë të hapur seancën publike për shqyrtimin e kërkesës ankimore me nr.6 që i përket "Koalicionit Aleanca". Përpara se të fillojmë, do të verifikojmë pjesëmarrjen. U thirr, u paraqit personi i cili ka parashtruar ankesën para KAS-it, i përfaqësuar në këtë gjykim administrativ nga avokati Erion Syziu. Është prezent edhe administrata e KQZ-së. Anëtarë të KAS-it ndonjë deklaratë paraprake për konflikt interesi? Nuk ka. Ndonjë kërkesë paraprake lidhur me trupin gjykues? Nuk ka. Atëherë mund të vijojmë me rrethanat e çështjes të cilat shkurtimisht po i lexoj unë. Atëherë me vendimin numër 108 datë 2 Mars 2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka regjistruar "Koalicionin Aleanca" si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e Kuvendit Shqipërisë të datës 25 Prill me shtatë parti pjesëmarrëse, Partia Aleanca Demokratike e Shqipëtare, Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, Partia e Reformave Demokratike e Shqipërisë, Partia e Aleancave për Drejtësi dhe Barazi Europiane, Partia Lëvizja


**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021*

Punëtore Shqiptare, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve, Partia Qytetare Shqiptare. Në datën 8 Mars 2021 “Koalicioni Aleanca” ka paraqitur në KQZ dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore. Me vendimin numër 138 Komisioneri Shtetëror ka vendosur kthimin për korrigjim të dokumentacionit. Brenda afatit ligjor subjekti ka riparaqitur edhe njëherë dokumentacionin e korrigjuar sipas tij. Në përfundim të procesit të verifikimit nga ana e Komisionerit janë konstatuar sërish mangësi dhe mospërmbushje të dokumentacionit si më poshtë. “Koalicioni Aleanca” nuk ka paraqitur dokument provues për plotësimin e kërkesave të nenit 68 të Kodit Zgjedhor. Koalicioni ka paraqitur vërtetim për zotërimin e dy mandateve në Kuvend. Partitë pjesëtare të “Koalicionit Aleanca” nuk vërtetojnë se zotërojnë bashkërisht në Kuvend numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëmarrëse në koalicion. Pra janë regjistruar sipas Komisionerit 7 parti pjesëmarrëse dhe kanë paraqitur vërtetim vetëm për dy mandate në Kuvend, ndërkohë që sipas detyrimit ligjor duhet të kishin paraqitur vërtetim për 7 mandate në Kuvend. Ose në rast të kundërt duhet të kishin paraqitur një listë mbështetëse me jo më pak se 7000 mijë zgjedhës në shkallë kombëtare. Kërkesa për miratimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet në zonën zgjedhore të Qarkut Korçë, është konstatuar me probleme sipas Komisionerit. Konkretisht kandidati me numër tre në Qarkun Korçë i cili është dhe kandidati me numër 31 në Qarkun Tiranë, zoti Klajdi Bufi nuk është regjistruar në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, pasi nuk plotëson kriterin për t’u regjistruar si kandidat i listës shumemërore vetëm në një zonë zgjedhore. Deklaratat e kandidatëve të listës shumemërore të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën e votës dhe se pranojnë të kandidojnë si kandidat të listës shumemërore të “Koalicionit Aleanca”, pra “Model 05” rezultojnë të plotësuar gabim për të gjitha zonat zgjedhore. Kandidati Genc Sulçe Sakaj, në listën e Vlorës, është brenda periudhës

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*




**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021**

së ndalimit për zgjedhjen në funksion kandidat për deputet në Kuvendin e Shqipërisë për arsye se është ende brenda afatit 10 vjeçar të parashikuar nga ligji 138/2015. Gjithashtu vihen re parregullsi sipas Komisionerit në dokumentacionin e kandidimit të kandidatëve për deputet në disa qarqe. Koncretisht në Tiranë kandidati me numër listë 07, në Durrës kandidati me numër liste 01 dhe 15. Në Elbasan kandidati me numër 13, 14 dhe 15. Në Shkodër kandidati me numër 9 dhe 11. Në Fier kandidati me numër 1, 6 dhe 16. Në Kukës kandidati me numër 2, në Vlorë kandidati me numër 1, në Gjirokastrë me numër 2, 4 dhe 6, dhe në Lezhë kandidati me numër 1. Për arsyet e lartpërmendura Komisioni Shtetëror me vendimin 165 të vitit 2021 ka vendosur refuzimin e listave shumemërore të “Koalicionit Aleanca” për Zgjedhje në Kuvendin e Shqipërisë. Në datën 20 Koalicioni sikurse e pamë edhe dje në seancë paraprake ka depozituar akim, të cilin e ka plotësuar sërish dje me disa dokumenta të cilat janë administruar tashmë edhe nga KAS-i, për të parashtruar kundërshtimet e juaja ndaj vendimit të Komisionerit objekt i këtij ankimi atëherë po ju ftoj, po ju lë fjalën në mënyrë që të na i prezantoni sipas rradhës, faleminderit!

Z. Erion Syziu, përfaqësues ligjor i Koalicionit Aleanca-Al: Të faleminderit zoti kryetar! Të nderuar anëtarë të komisionit, më lejoni që t’iu japim sqarimet tona në lidhje me ankimimet dhe me rrethanat e kësaj çështje. Është e vërtetë fakti që subjekti politik “Koalicioni Aleanca” përfaqësohet në Parlamentin e Shqipërisë nga dy mandate dhe kjo është e vërtetuar dhe nga vërtetimi përkatës i marrë nga Kuvendi i Shqipërisë dhe që është bërë pjesë e dosjes se këtij koalicioni pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por nuk është i vërtetë fakti që ky koalicion, tashmë ka në përbërjen e saj 7 subjekte politike apo 7 parti politike. Ka rezultuar e provuar dhe mund të vërtetohet edhe në këtë procedurë administrative pranë këtij


**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021**

komisioni që ky subjekt politik, "Koalicioni Aleanca" ka në përbërje vetëm dy parti politike dhe konkretisht Partinë Aleanca Demokratike Shqiptare dhe Partinë e Reformave Demokratike të Shqipërisë. Në vendimin numër 165, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka pretenduar dhe ka mbështetur tërësisht vendimin e tij për refuzimin e listave shumëmemërore pikërisht në faktin se ky koalicion duhet të kishte sjellë vërtetimin që përfaqësohet në Parlamentin e Shqipërisë nga 7 mandate. Dhe ky është një konstatim i përsëritur nga ana e Komisionerit. Por ka rezultuar dhe ne mund t'a vërtetojmë që 5 nga 7 subjektet politike janë tërhequr nga ky koalicion, dhe konkretisht janë tërhequr subjekti Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve, dhe Partia Qytetare Shqiptare. Për këtë qëllim përfaqësuesit politik të këtyre subjekteve në datën 12.03.2021 kanë nënshkruar një deklaratë e cila konsiston në tërheqjen nga koalicioni që lidhet me subjektin zgjedhor Aleanca për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të datës 25 Prill 2021. Për rrjedhojë ka dhe një deklaratë të po asaj date ku vërtetohet fakti që ky koalicion me emërtimin Aleanca vazhdon nga dy subjekte politike që janë partitë që unë ju citova më lartë dhe që aktualisht përbëjnë dhe këtë koalicion. Ka rezultuar që me datën 16 pas njoftimit me vendimin numër 138 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për plotësimin e disa të metave në dokumentacionin e subjektit politik ka rezultuar e provuar që nga ana e "Koalicionit Aleanca" nëpërmjet procesverbalit për dorëzimin e dokumentacionit të kandidimit, është protokolluar pranë protokollit të këtij institucioni dokumentacioni që mungonte apo sipas Komisionerit kishte mangësi. Në këtë dokumentacion janë bashkëlidhur listat e kandidatëve të cilët janë regjistruar apo propozuar nga subjekti politik për të kandiduar në zgjedhje dhe përbri emrit të secilit kandidat është shënuar dhe subjekti politik që e ka propozuar kandidatin, ku vërtetohet që të gjithë kandidatët

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021**

janë propozuar vetëm nga dy subjekte politike që janë subjektet politike që e përbëjnë koalicionin tashmë. Pra të gjithë partitë e tjera të cilët ne i konsiderojmë dhe i kërkojmë dhe këtij komisioni të konsiderojë si subjekte të cilat nuk përfaqësojnë më Aleancën në këto zgjedhje, janë tërhequr dhe nuk kanë bërë propozimet e tyre për kandidatë. Tani referuar udhëzimit për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet dhe publikimin e listave të kandidatëve, udhëzimin numër 1 i datës 23 Dhjetor 2020, në nenin 2 të tij është parashikuar që regjistrimi i koalicioneve zgjedhore përmban, marrëveshjen ndër të tjera, "Marrëveshjen e Koalicionit", ku në marrëveshje duhet të përmbahet të paktën numrin, germa "e" numrin e kandidatëve që duhet të propozoj secila parti politike brenda koalicionit për çdo zonë zgjedhore. Ndërkohë që rezulton që në listat e subjektit Aleanca, partitë politike të tërhequra "de fakto" nga ky koalicion nuk kanë bërë asnjë propozim për kandidat kjo për faktin që në datë 12.03. 2021 po anëtarët, po partitë politike, që përbënin këtë koalicion kanë bërë deklaratën e tyre për tërheqjen nga koalicioni dhe me datën 16 pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është sjellë lista me kandidatët sipas propozimeve vetëm nga dy subjekte politike. Tani është e vërtetë fakti që bashkëlidhur këtij procesverbali nuk gjendet deklarata e datës 12.03.2021, pasi nëse kjo deklaratë do të ishte pjesë e këtij dokumentacioni, ne mendojmë që vendimi i Komisionerit nuk do të ishte për refuzimin tërësisht të listave. Ne mendojmë që kjo është një anomali që në vetvete dhe në thelb prek edhe vetë administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Sipas udhëzimit neni 1, pika 4, thuhet që nëse vërehen mangësi jothelbësore në dokumentacion, administrata kontakton menjëherë me përfaqësuesin e subjektit politik dhe i kërkon korigjime te metave, ose kërkon nga organe të tjera shtetërore vërtetime ose të dhëna të paraqitura nga partia politike. Administrata e KQZ-së, në momentin që ka

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve**

Dt.24.03.2021

konstatuar që të gjithë kandidatët të gjendur në listat bashkëlidhur, janë propozuar vetëm nga dy subjekte politike, ku ky koalicion sipas vendimit numër 108, duhet të përfaqësohej nga 7 subjekte politike, ku 5 prej tyre nuk kanë propozuar asnjë kandidatë, në kohë reale do të ishte e mjaftueshme që të njoftonte kryetarin e partisë udhëheqëse të koalicionit mbi këtë problematikë të hasur dhe do të ishte shumë e thjeshtë dhe një rrugë shumë e shkurtër për përfaqësuesin politik që të administronte në protokollin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe deklaratën për tërheqjen nga koalicioni të 5 subjekteve politikë si dhe deklaratën tjetër të dy subjekteve politike të mbetura në koalicion që garën elektorale t'a vazhdonin ndërmjet tyre. Ka dhe një rrethanë tjetër i nderuar zoti kryetar dhe të nderuar anëtarë. Është në seancën dëgjimore, por këtë mund t'a sqarojë më mirë dhe vetë përfaqësuesit. Kur është ngritur i njëjti pretendim, i është kërkuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve një pushim pak minutësh me qëllim që kjo deklaratë të behesh pjesë e dosjes së subjektit politik dhe të depozitohet në protokollin e këtij institucioni, gjë që nuk është lejuar dhe Komisioneri në mënyrë të atyçastme ka marrë vendimin për refuzimin tërësisht të listave. Ne i kërkojmë këtij komisioni, që në mënyrë absolute të vlerësojë faktin se ky koalicion politik përbëhet nga dy parti politike, kjo mbështetur edhe në provat e reja që ne, provat nuk janë të reja por që ne i administronim por që nuk mund t'i depozitonim "post factum" në sekretarinë e KQZ-së pasi ky institucion tashmë e kishte marrë vendimin dhe u detyruam që t'ia paraqesim këtij komisioni. Të gjetur përpara një procedure administrative dhe referuar edhe parashikimit të Kodit Zgjedhor ku thuhet që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe organet e tij ndihmëse ushtrojnë veprimtari administrative edhe sipas Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ne i kërkojmë këtij komisioni që sipas parashikimit të nenit 80 dhe vijues të këtij kodi t'i administrojë dhe t'i vlerësojë në cilësinë e provës materiale deklaratat e

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021*

subjekteve politike të cilat janë të tërhequra nga komisioni. Kjo për faktin se për ezaurimin dhe për sqarimin e rrethanave që lidhen me pikën e parë të të metave në dokumentacionin e “Koalicionit Aleanca” dhe që janë konstatuar në vendimin nr.165 ne mendojmë që ky dokumentacion i sjellë rishtazi do t’i provoj këtij komisioni në mënyrë shteruese pretendimin dhe faktin që koalicioni tashmë përfaqësohet vetëm nga dy subjekte politike për të cilat vërtetohet që përfaqësohen rregullisht në Parlamentin e Shqipërisë sipas Kodit Zgjedhor nga dy deputet të cilat janë gjithashtu edhe kandidat në listat shumëmemërore të subjektit politik “Koalicionit Aleanca” ndërsa në lidhje me pikat e tjera të të metave të konstatuara në dokumentacionin e subjektit politik, kemi konstatuar që kryesisht përveç zotit Bufi të gjithë kandidatët e tjerë paraqesin mangësi të cilat lidhen me kriteret e aplikimit të ligjit nr.138 të vitit 2015 dhe që kanë të bëjnë kryesisht me formularin e vetëdeklarimit. Në lidhje me zotin Sakaj, Genci Sulçe Sakaj për të cilin nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, pretendohet që ka pengesë për shkak sepse është në periudhën 10 vjeçare të ndalimit sipas parashikimit të ligjit nr.138 ne i kërkojmë këtij komisioni që t’a rivlerësojë edhe njëher këtë vendim mbi bazën e dokumentacionit që vetë ky kandidat ka sjellë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pasi në gjykimin tonë ky afat tashmë është i tej kaluar. Në vitin 2008 zoti Sakaj në datën 29 Dhjetor 2008 është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me 3 vite burgim dhe një gjobë në masën 1 milion lekë e konvertuar kjo si aplikim i masës së dënimit në dy vjet dënim kohë prove që do të kryhej pranë shërbimit të provës. Ndërkohë që në ligjin nr.138 të vitit 2015 neni 4 pika 3, thuhet që afati i ndalimit do të llogaritet nga momenti i përfundimit të dënimit me burgim” ç’ka do të thotë që ky subjekt duhet të ishte dënuar me burgim dhe masa e dënimit të tij duhet të ishte zbatuar pikërisht në atë formë, pra me burgim, pra duhet që ndëshkimi i tij penal duhej të ushtrohej në institucionin e burgimit,

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021*

ndërkohë që për këtë subjekt nuk është vendosur kjo gjë, por është bërë konvertimi me kohë prove, është vendosur në provë, pra ka qenë në gjendje të lire, por i kufizuar sipas sanksioneve që parashikon ligji i posaçëm për shërbimin e provës, pra ky person nuk është dënuar me burgim. Veç kësaj vendimi i gjykatës, mendojmë që koha e ndalimit duhet të llogaritet nga vendimi, nga koha kur vendimi i është dhënë i formës së prerë për subjektin Sakaj. Megjithatë qëndrimi politik i koalicionit është i tillë, që edhe nëse ky komision nuk do ta ç'mojë këtë rrethanë, përsëri ne mendojmë, dhe është e provuar që edhe për subjektin Sakaj refuzimi, argumenti i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka të bëjë vetëm me aplikimin e ligjit numër 138 të vitit 2015. Për këtë kategori subjektsh, të cilët kanë probleme me ligjin e dekriminalizimit le të themi, sipas parashikimit të nenit 6 pika 2 të udhëzimit numër 1 të Dhjetorit 2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve refuzon kandidatin, sepse janë cilësi të lidhura ngushtësisht me personalitetin e kandidatit, me kandidatin, dhe një kandidatë i cili refuzohet për të kandiduar mund të zëvendësohet nga një kandidat tjetër që e propozon subjekti politik. Kjo sipas parashikimit të udhëzimit, ku parashikohet se; "kur kandidati nuk i plotëson kushtet për të qenë si i tillë dhe që ka pengesë ligjore sipas parashikimit të ligjit numër 138 të vitit 2015, subjekti politik që e ka propozuar i jepet mundësia që këtë kandidatë ta zëvendësojë me një kandidatë tjetër". Po ashtu e njëjta situatë rezulton edhe për të gjithë subjektet e tjerë të parashikuar në vendimin numër 165 dhe konkretisht, në Qarkun e Tiranës kandidati me numër rendor 7, në Qarkun e Durrësit kandidati numër 1 dhe 15, dhe kështu me rradhë, që janë përmendur të gjithë në këtë vendim. Konstatimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet. Ne mendojmë që edhe kjo rrethanë duhet të shikohet me vëmendje dhe duhet të shikohet në mënyrë të detajuar dokumentacioni që ka sjellë kandidati. Sepse sipas

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021**

procesverbalit të dorëzimit me numër 1786/1, datë 16.03.2021 të sjellë nga subjekti politik, në rubrikat përkatëse vërtetohet që dokumentacioni i depozituar në të janë formular vetëdeklarimi, dhe janë formular vetëdeklarimi për të gjithë ata subjekte të cilët janë konstatuar me probleme në vendimin numër 138. Dhe ne mendojmë që administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk ka bërë analizën e duhur të këtij dokumentacioni dhe nuk i ka evidentuar plotësisht problematikat sepse kemi konstatuar dhe një problem tjetër, ato subjekte, kandidatë të cilët nuk rezultonin me probleme në vendimin numër 138, kanë dalë me probleme në vendimin nr.165 që është edhe vendimi i fundit shterues, ç'ka qenë një rregullsi e panjohur për ne. Si shembull mund t'iu marrim për shembull kandidati me numrin 1 në Qarkun Tiranë, Vlorë, Berat dhe Fier është zoti Eduard Abazi, i cili sipas vendimit figuron me probleme përse i përket dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit për kandidimin në Qarkun Fier dhe Vlorë por nuk figuron me probleme në Qarkun Tiranë dhe Berat. Tjetër, zoti Krenar Rryçi, kandidati me numër 1 në Qarkun e Durrësit sipas vendimit nr.138 të datës 11.03.2021 nuk ka pasur asnjë mangësi. Pra nuk është vërejtur nga Komisioneri, që të kishte një mangësi të cilën ky subjekt duhet t'a plotësojë apo subjekti politik që e ka propozuar duhet t'a plotësoj por ka rezultuar me probleme në vendimin nr.165. Megjithatë në përmbledhjen tonë i nderuar zoti Kryetar, të nderuar anëtarë ne këmbëngulim që ky komision të vlerësoj drejtë rrethanat që lidhen me shkaqet e refuzimit në tërësi të listave të subjektit politik, dhe që janë të lidhura ngushtësisht vetëm me elementin e përputhshmërisë së numrit të partive politike që kanë shfaqur vullnetin për të marrë pjesë në zgjedhjet e datës 25 Prill me përfaqësinë e tyre në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë. Sipas një deduksioni do thonim juridik, por edhe logjik përse kohë në listat e propozuara nga subjekti Aleanca, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.


**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021*

Z. Erion Syziu, përfaqësues ligjor i Koalicionit Aleanca-Al: Rezulton e provuar që të gjithë kandidatët janë propozuar vetëm nga 2 subjekte politike si dhe dokumentacionet shtesë që ne kemi sjellë pranë komisionit, ku vërtetohet që të 5 subjektet politike të tjera që kanë qenë anëtarë të këtij koalicioni, tashmë janë dorëhequr, kanë shprehur vullnetin e tyre për të mos marrë pjesë, për të mos propozuar kandidatë, atëherë ne i kërkojmë këtij komisioni që, me administrimin si prova të këtyre deklaratave dhe sipas parashikimeve të nenit 80, Kodi i Procedurave Civile, t'i administrojë dhe t'i vlerësojë në përputhje me të gjithë dokumentacionin e mëparshëm të zgjedhur nga subjekti politik dhe për këtë pikë, vendimi numër 165, i dhënë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për refuzimin në tërësi të listave të këtij subjekti politik, të ndryshohet. Ne në objektin e kërkesës tonë, gjithashtu kemi kërkuar si pikë të dytë, që të lejohet regjistrimi i kandidatëve për deputet, në Parlamentin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, sipas listave shumemërore të propozuara nga Koalicioni Aleanca, duke e vlerësuar tashmë që ky koalicion ka në përbërjen e saj vetëm 2 parti politike. Ndërsa në lidhje me të gjitha shkaqet e tjera dhe sidomos ato që lidhen ngushtësisht me aplikimin e ligjit numër 138, ne vlerësojmë që jemi përpara rastit ku çdo kandidat mban përgjegjësitë e veta dhe nëse ka papajtueshmëri me parashikimet e atij ligji, është kandidat që mund të përjashtohet vetëm ai si kandidat dhe subjekti politik mund ta zëvendësojë kandidatin e tij. Jemi në kohën e përshtatshme, jemi në kohën e duhur kur ky korigjim, ky plotësim, mund të realizohet për sa kohë dhe sipas udhëzimit listat e kandidatëve përfundimtarë, do të dalin vetëm pas përfundimit të procedurave të ankimimit. Jemi në një procedurë ankimimi, për subjektin politik nuk ka përfunduar plotësisht procedura administrative, apo ajo e mëpasshme gjyqësore. Kështu që, mendojmë që kërkimi ynë është i mbështetur në ligj, është i mbështetur në prova dhe është krejtësisht i mundshëm që të realizohet edhe nga

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021**

vendimarrja e këtij komisioni, që mund të jetë më e gjerë nga ajo çfarë kemi kërkuar, me qëllim që ti jepet një rregullim i përgjithshëm të gjitha pasojave të pritshme në lidhje me subjektin Aleanca. Në vija të përgjithshme kaq kisha, ndërsa, po, harrova në lidhje me zotin Bufi, është i vërtetë dhe kjo është pranuar edhe nga ana jonë që ai është regjistruar gabimisht, është një gabim njerëzor që është regjistruar në 2 qarqe, realisht ai duhej të ishte regjistruar vetëm në Qarkun e Tiranës dhe jo në Qarkun e Korçës, në Qarkun e Korçës dhe jo në Qarkun e Tiranës, por edhe kjo është një mangësi e një rrethane të tillë që, nëse administrata në momentin e pranimit të dokumentacionit apo në momentin e mëpasshëm do ta konstatonte këtë gjë, në kohë reale, subjekti politik do ti përgjigjesh kësaj mangësie dhe do ta kishte korigjuar. Kaq kisha për të sqaruar në lidhje me ankimimin!

Z. E. Çefa: Faleminderit avokat! Nga kolegët, ndonjë pyetje? Po zoti Rusmali?

Z. I. Rusmali: Sipas ligjit ju keni patur mundësinë që të bënit korigjimet e mangësive në dokumentacion, brenda 48 orëve. Ju keni ri paraqitur me mangësi, pse ka ndodhur kjo?

Z. Erion Syziu, përfaqësues ligjor i Koalicionit Aleanca-Al: Ju faleminderit! Realisht neve kemi pasqyruar të gjitha vërejtjet që na kanë ardhur me vendimin numër 138. Janë të pasqyruara dhe të depozituara një për një, madje specifikisht neve edhe në një pjesë të vendimit të ankimit që kemi bërë, i kemi përmendur disa prej të cilave i kujtoi dhe avokati, ka qëlluar numri 07 i Tiranës, që juve sapo e cituat, e citoi relatori, është po i njëjti person, ka qenë më numrin 7 në Tiranë, ka mbetur po ai. I kemi bërë të gjitha vërejtjet.

**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021*

Z. I. Rusmali: Po tregon historinë tënde, unë dua të tregosh historinë time. Janë kthyer për mangësi, janë ri paraqitur dhe vendimi përfundimtar përsëri konstaton mangësi. Pse kanë ardhur mangësitë? Pse në vendimin përfundimtar nuk janë të qepura? Ka ndonjë motiv për këtë?

Z. Eduard Abazi, përfaqësues i Koalicionit Aleanca-Al: Vetëm Klajdi Bufi dhe 2 gabime teknike për shkak të kompjuterit tek formulari numër 5, që na kanë shpëtuar edhe tek rasti i dytë, kurse të gjitha rastet e tjera rast pas rasti, nga vërejtjet janë pasqyruar dhe janë specifikuar të gjitha, duke filluar edhe me mandatet që kishim, ndaj dhe kemi bërë pasqyrimin me 2 sigla se mbetën 2 subjekte tek sqarimet shteruese që bëri avokati dhe të gjitha vërejtjet e tjera janë pasqyruar dhe kur na kanë ri ardhur ne kemi bërë një sqarim për secilin nga rastet, duke thënë se ku janë dokumentat e të parit që kanë qenë të rregullta dhe si na vjen vërejtja tek rasti i dytë. Pra po të kishim gjetur të tjera do ti kishim plotësuar natyrisht,

Z. I. Rusmali: Më lejoni të shtoj në qoftëse ka mundësi, nga vendimi sigurisht. Deklaratat e kandidatit të listave shumemërore të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën e votës dhe se pranojnë të kandidojnë si kandidatë të listës shumemërore të Koalicionit Aleanca, modeli 05, rezultojnë të plotësuar gabim për të gjitha zonat zgjedhore. Ky është në vendim, ky është vendimi.

Z. Eduard Abazi, përfaqësues i Koalicionit Aleanca-Al: I fundit?

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021*

Z. I. Rusmali: Të gjitha, i fundit, këtë po lexoj. A është 165 i fundit? Që të kuptojmë që jemi të dy palët në të njëjtin realitet, në të njëjtën botë po jetojmë, nuk po jetojmë në botë të ndryshme. Kjo thotë të gjitha gabim.


Z. Eduard Abazi, përfaqësues i Koalicionit Aleanca-Al: Na e thotë tek vendimi i dytë jo tek i pari. Se po ta kishim tek i pari do ti reflektonim.

Z. Erion Syziu, përfaqësues ligjor i Koalicionit Aleanca-Al: Me leje, mund të?

Z. E. Çefa: Po avokat, vazhdo!

Z. Erion Syziu, përfaqësues ligjor i Koalicionit Aleanca-Al: Po. Mangësitë që pretendohet që në vendimin numër 165, të gjithë këto modularë janë plotësuar gabim. Në fakt duhet të na thoshe se çfarë është plotësuar gabim në ato formularë, gjë të cilën nuk e ka sqaruar në mënyrë të detajuar në vendimin numër 165, por në mënyrë të detajuar në këtë vendim dhe ne për këtë dhe j'u përgjigjëm komisionit, janë sqaruar papajtueshmëritë me formularët e vetëdeklarimit, për subjektet sipas emërtimit që ka bërë në vendim. Subjekti numër 7 në Qarkun e Tiranës, 1 dhe 15 në Qarkun e Durrësit, 13, 14 dhe 15 në Elbasan dhe kështu me rradhë. Nëse ky formular është plotësuar gabim, duam ta dimë se çfarë është plotësuar gabim në këtë formular. Nuk mund të thuhet që është plotësuar gabim, çfarë është shënuar emri gabim, është shënuar mbiemri gabim, është checkuar gabim, është i pavlefshëm formulari, është një gabim material i korigjueshëm, është një gabim material i interpretueshëm, çfarë natyre ka ky gabim në këtë formular? Pasi penaliteti që e ka shoqëruar sipas vendimit, është ekstrem, nuk ka penalizuar

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021**

kandidatin dhe ne këtu nuk pajtohemi me vendimin e Komisionerit. Ka penalizuar në tërësi subjektin për të marrë pjesë në zgjedhje, jo kandidatin.

Z. E. Çefa: E kuptoj!


Z. I. Rusmali: Duhet të kuptojmë historinë, ka patur seriozitet nga subjekti gjatë procedurës, apo jo dhe nëqoftëse vërejtja nga Komisioni vjen në mënyrë të përsëritur, rregulloni formularin dhe formulari nuk rregullohet, duhet zbuluar se kush është shkak, ju thoni që e keni patur herën e parë në rregull dhe herën e dytë j'u a kanë konstatuar gabim. Le të na e sqarojë administrata.

Z. E. Çefa: Zoti Olsi!

Z. O. Peto: Në momentin e depozitimit të listave të datës 08.03.2021, subjekti Aleanca depozitoi të gjithë dokumentacionin. Nga verifikimi, nga ana jonë e administratës, u konstatua me probleme dokumentacioni ku u kthye dhe kthimi për korrigjim i materialit. Kur e ri solli të ri korrigjuar sipas subjektit, u konstatuan parregullsi voluminoze të dokumentacionit, pasi kandidatët ishin transferuar nga, po themi për shembull nga Tirana në Qarkun e Lezhës, nga Lezha në Korçë dhe nuk përkonte emri i kandidatit me qarkun përkatës që e kishin depozituar herën e parë. Pra, nëse herën e parë Olsi ishte në Qarkun Tiranë, në listat e dyta kur ka ardhur ka qenë, deklarata ka qenë në Qarku Tiranë dhe ai nuk ishte më në Tiranë ishte në Berat po themi. Kjo ishte e gjitha.

Z. E. Çefa: Pra nëse e kam kuptuar mirë, nuk ishin rifreskuar deklaratat me gjendjen e re në lista. Ky ishte problemi?

**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021**

Z. O. Peto: Po me listat e reja. Ky ishte problemi.

Z. E. Çefa: Ky është problemi, i cili nuk kishte si të reflektohej në vendimin e parë të kthimit pikërisht për këtë arsye. E qartë!

Z. O. Peto: Po për korrigjim, se nuk e dinim që do të ndryshonte gjithë lista dhe gjithë propozimi nga ana e subjekteve.

Z. Erion Syziu, përfaqësues ligjor i Koalicionit Aleanca-Al: Por duhet të konsiderojmë që kandidatët tashmë janë propozuar vetëm nga 2 subjekte.

Z. I. Rusmali: Nga shpjegimi që ka pas mospërputhje midis vendit të kandidatit në listë, qarkut dhe vullnetit të kandidatit për të kandiduar, qarkut. Pra nëqoftëse ka lëshuar një deklaratë që është i gatshëm të kandidojë në Qarkun e Tiranës dhe është çuar që të kandidojë në Qarkun e Korçës, ky vullnet nuk përputhet, këtë kuptuam neve. Domethënë kjo është e saktë, apo jo, jeni dakord dhe ju me këtë, apo nuk ju rezulton e vërtetë?

Z. Eduard Abazi, përfaqësues i Koalicionit Aleanca-Al: Duke mos pretenduar që po themi të vërtetën, gjithçka, unë deri në orën 12 të natës që shteronte afati, kam komunikuar me administratën e .,

Z. I. Rusmali: Jo, të lutem, por prapë,,

**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021*

Z. Eduard Abazi, përfaqësues i Koalicionit Aleanca-Al: Ju lutem, për të plotësuar këto që thoni juve, korrespondecën midis materialit ku ishte dhe personit,

Z. I. Rusmali: Jo është çështje tjetër. Për këtë bëjmë pyetje tjetër ne. Ne duhet të kuptojmë a është e vërtetë pasaktësia apo jo, është apo jo? Kaq duam ne.

Z. Eduard Abazi, përfaqësues i Koalicionit Aleanca-Al: Gabime teknike, po!

Z. I. Rusmali: Dakord! Një pyetje për administratën, nëqoftëse është e mundur. Koalicioni është regjistruar brenda afatit ligjor, si koalicion në bazë të marrëveshjes së tij si koalicion i 7 partive. Kur ka ardhur për të regjistruar listën e kandidatëve, ka rezultuar për ju që ishte një koalicion i 2 partive. Unë nuk e kam vëmendjen ke historia, dokumentacioni provues, marrëveshja shtesë, vullneti i palëve për t'u larguar, etj etj. Në momentin që ju konstatuat që koalicioni kishte ndërruar formën, e patë mundësinë që ti thonit 2 subjekteve që koalicioni juaj ka rënë tashmë, por ju keni të drejtën të regjistroheni si parti politike sepse jeni të regjistruara si të tilla.

Z. O. Peto: Ne nuk kemi qenë në dijeni fare, në momentin e depozitimit të datës 08, që ishte afati i fundit për regjistrimin e listave, subjekti ka depozituar listat kështu siç e pohoi dhe avokati, me 7 subjektet zgjedhore pjesëtare të koalicionit. Në momentin që është evidentuar nga kthimi për korigjim i akteve pastaj, unë sot e marr vesh që janë depozituar dhe këto deklaratat, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka patur dijeni fare për këtë.

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve**

Dt.24.03.2021

Z. E. Çefa: Atëherë në vijim të kësaj pyetje prapë për administratën, a është i vërtetë pretendimi që bëri pala ankuese këtu, se në seancën e zhvilluar me Komisionerin është kërkuar pushim, pikërisht për të sjellë këto deklarata dhe ky pushim nuk është dakorduar?

Z. O. Peto: Në dijeninë time jo. Nuk është kërkuar fare pushim.


Z. E. Çefa: Si mund ta, domethënë kemi ndonjë mjet për ta verifikuar këtë?

Z. Y. Merkaç: Kemi procesverbalin e mbledhjes, është i zbardhur dhe mund ta vëmë në dispozicion.

Z. E. Çefa: Dakord! Po. Atëherë ju lutem do na bëni një kopje që ta kemi pak më vonë, ju lutem një kopje të këtij proces verbali. Një pyetje për ankuesin, shoh edhe njëherë listat e kthyer nga vendimi, objekt ankimi dhe ndryshe nga sa ju pretendoni që në këtë koalicion janë vetëm dy parti politike, mua më rezulton që tek lista e Vlorës, numri rendor 11 dhe numri rendor 12 janë të një partie PQSH, që duhet të jetë Partia Qytetare e cila në këtë fazë, është teorikisht jashtë koalicionit, apo jo? Atë kam unë listën e datës 16, listën që është bashkëlidhur vendimit objekt ankimi apo jo? Pyetja ime është, a jemi përpara një gabimi tjetër material apo ka një shpjegim tjetër për këtë?

Z. Eduard Abazi, përfaqësues i Koalicionit Aleanca-Al: Duke ju falenderuar realisht, për shkak të axhendës së ngjeshur që kemi patur dhe ballafaquar rast pas rasti me të gjitha vërejtjet, nëse kjo do të jetë e fundit, është një gabim material natyrisht, është një lapsus që ka ndodhur sepse vetë përfaqësuesi i PQSH-së,

**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021**

përmes një deklaratë, ka qenë i tërhequr dhe ka patur të depozituar tek ne, është një, ashtu siç ka ndodhur edhe gabimi material tek zoti Klajdi Bufi, që i cili edhe në listat e para ka qenë vetëm në Korçë dhe tek të dytat ka rezultuar edhe gabimisht edhe në Tiranë, që nuk ka përse. Sepse jemi marrë vetë dhe i kemi ndjekur me shumë përkushtim natyrisht, për të qenë pjesë e kësaj gare. Tani po njihem realisht dhe për shkak të ngarkesës, që paska ndodhur edhe një lapsus i tillë dhe ju falenderoj që e konstatuat, është natyrisht një gabim material, të jemi shumë të sigurtë, se nuk bëhet fjalë që,


Z. E. Çefa: Në të njëjtën listë është dhe subjekti me numër 5 që është prapë Partia ABDE, që duhet të jetë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane,

Z. Y. Merkaçaj: Edhe numri 2 në listë është kryetari i Partisë Lëvizja Popullore Shqiptare, për atë punë,

Z. E. Çefa: Dakord! E sqaruar, atëherë pyetje të tjera për ankuesit nuk ka, për administratën nuk ka. Atëherë sipas procedurës, ne do t'ju kërkojmë të na falni pak për, për pak kohë. Po sigurisht, po urdhëro, patjetër!

Z. Eduard Abazi, përfaqësues i Koalicionit Aleanca-Al: Pra, pa pretenduar që t'ju ha dhe kohën natyrisht, duke ju falenderuar për mundësinë që na jepni të shprehemi pa përsëritur edhe gjetjet edhe punën nga administrata edhe deklaratimet e djeshme të sekretarit të KQZ-së, duke e falenderuar natyrisht për bashkëpunimin që kemi bërë, jemi shumë rigorozë në tonën natyrisht, për të qenë bashkëpunues me institucionin e KQZ-së dhe për të shteruar të gjitha gabimet ose difektet që janë. Ndaj pas gjetjeve të datës, dorëzimeve të datës 8 mars dhe 11 mars, ne i


**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021**

pasqyruam dhe i shoqëruam me mandatet e deputetëve, me vërtetimet përkatëse të tyre dhe brenda afatit të datës 16, ne i pasqyruam edhe ato difekte të cilët u thanë, përveç vërejtjeve që na ishin në vendimin e 138. Lidhur me problemin e mandateve, u shteruan nga avokati nuk dua të zgjatem më, por nëse do të na kërkohet një sugjerim ose do të na sugjerohej që të korigjonim diçka për shkak të bashkëpunimit ne nuk kemi refuzuar madje kemi kërkuar kohë pas kohe, edhe një gjë po them edhe shpalljen e vendimit të datës 18, u hodh në faqen zyrtare në datë 19, pas mesnate tek faqja zyrtare e KQZ-së, se vetëm atëherë u hodh. Unë kam kërkuar edhe të bashkëpunoj me zotin Olsi, si përfaqësues juridik, nuk më kthente përgjigjë përmes WhatsApp-it dhe vetëm atë ditë, në të gdhirë të datës 20, u njohëm me vendimin dhe morëm masat për të bërë ankimimin. Duke mos u marrë zë për zë, për të gjitha vërejtjet dhe duke qenë të përkushtuar për të qenë pjesë e garës natyrisht, po ju them që ne u jemi përgjigjur me shumë rigorozitet dhe me mundësitë që kishim patur, natyrisht. Ju drejtohem juve dhe duke marrë në konsideratë edhe vërejtjet dhe sugjerimet që bëmë, shpresojmë që komisioni juaj të bëjë një vlerësim sa më të saktë, të bindur që vullneti i 153 kandidatëve, që tashmë kanë qenë shumë bashkëpunues, qoftë për lëvizjet dhe gabimet materiale që kanë ndodhur duke bashkëpunuar me njëri tjetrin, duke qenë edhe të bindur sepse ky Kod Zgjedhor, ka ndryshuar mbi 70 përqind të materialit të parë që kishte dhe implementimi i tij do të ishte i vështirë edhe për njerëzit specialistë dhe të përditësuar më shumë problemet e tyre dhe jo më për njerëzit e tjerë që pak u takon të ndeshen për shkak të problemeve rutine. Ndaj e kisha bindje dhe them që, të gjitha institucionet që prodhohen për realizimin e një palë zgjedhje, duhet të jenë jo vetëm bashkëpunuese por të sigurojnë së paku minimumin dhe të drejtën e çdo qytetari të zgjedhë dhe të zgjidhet, ndaj ju kujtova 153 kandidatët që kërkojnë të zgjidhen dhe me qindra apo me disa dhjetëra apo me mijëra mos themi, mos e

**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021**


informalizoj, mbështetësve tanë që presin për të na votuar. Me shpresë që juve do të merrni një vendim të saktë për vazhdimin!

Z. E. Çefa: Faleminderit! Atëherë si konkluzione përfundimtare, besoj fjala e kryetarit të Partisë mjafton, apo avokat, përfundimisht?

Z. Erion Syziu, përfaqësues ligjor i Koalicionit Aleanca-Al: Po besoj është e mjaftueshme, ne mendojmë që e kemi ndarë ankimin tonë në dy elementë, elementi thelbësor është përshtatshmëria e koalicionit me kriterin ligjor për të patur përfaqësimin në parlament dhe mendojmë që kjo është hallka më e rëndësishme, që do të vlerësohet nga ky Komision, pasi në rast se ky Komision do ta çmojë që po ky koalicion vërtet përfaqësohet nga 2 parti politike, problemi tjetër që lidhet me listat apo me cilësitë e kandidatëve, është krejtësisht i zgjidhshëm deri në çastin e shpalljes së listave përfundimtare, mund të hiqet një person që mund të konsiderohet problematik, mund të korigjohet një person i vendosur gabim në atë listë, por thelbi është pikërisht kjo që ne mendojmë që duhet të na cojë drejt zgjedhjeve!

Z. E. Çefa: Atëherë ju faleminderit! KAS-i do tërhiqet, në dhomë këshillimi për të diskutuar çështjen dhe vendimin përfundimtar do ju a bëjmë me dije pas pak, ndoshta 30 minutash apo diçka më tepër. Kështu që jeni të lutur të na prisni, të na jepni pak kohë. Faleminderit!

**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.03.2021*

Rifillon mbledhja

Ora 15:11

Z. E. Çefa: Atëherë Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, i mbledhur sot në seancë publike, në datë 24.03.2021, pasi e diskutoi çështjen në tërësi dhe vlerësoi provat shkresore të administruara në këtë proces, unanimisht vendosi:

-Rrëzimin e kërkesës ankimore numër 6, datë 20.03.2021, të subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca –Al.

-Lënien në fuqi të vendimit nr. 165, datë 18.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listave shumemërore të Koalicionit Aleanca, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

-Kundër këtij vendimi keni të drejtën e ankimimit në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, brenda 5 ditëve nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Seanca deklarohet e mbyllur! Faleminderit!

Vendimi nr. 11

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*

